

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pse nuk bind alibia e kryeministrit "leshko", që nuk e dinte për Vlora Hysenin dhe Ergys Agasin
ADRESA	https://lapsi.al/pse-nuk-bind-alibia-e-kryeministrit-leshko-qe-nuk-e-dinte-per-vlora-hysenin-dhe-ergys-agasin-i1094585
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 15:37:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 15:36:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c521f853617d27522b650ed0a7935a236161a39e6975d823b89a5cd33483cfed
TEKSTI	d6334ce6638c2ee3047af63d8f1f218e466460fa28617ba5d4ffda1a144a228f
PAMJA	f8a7c1c32a280c7df14211cadf7295d11ee372da631a14eb9270c171bed60368

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	726da7307cf02a8878adfe007abd19c1df630505b1a81ef79c7900fdd18c43d3
E MËPARSHMJA	d996b77f0660e028257dd233984bd826c2af3c0bc179907ea435165257abcb80
RRËNJA MERKLE	b1c7a27947b4cc546e59bf39e541eaf49f294f8d53ee0afce777d7f589624631
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/726da7307cf02a8878adfe007abd19c1df630505b1a81ef79c7900fdd18c43d3

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Pse nuk bind alibia e kryeministrit "leshko", që nuk e dinte për Vlora Hysenin dhe Ergys Agasin

Nëse Edi Rama nuk dinte asgjë për pushtetin e Ergys Agasit dhe marrëdhënien e tij me Vlora Hysenin, atëherë mbetet për t'u shpjeguar se si një biznesmen pa asnjë funksion shtetëror kontrollonte tenderat e AKSHI-t, urdhëronte shefat e policisë, merrte informacione nga drejtuesja e SHISH dhe sillej me ministra e ish-ministra socialiste sikur të ishin vartësit e tij.



LAPSI.AL • 27 SEPTEMBER 2026



Nga Dorian Kodra

Në daljen e tij pas kthimit nga Nju Jorku, Edi Rama përsëriti të njëjtën linjë mbrojtjeje që ka përdorur sa herë ushtari i tij i radhës del në dosjet e SPAK-ut: përgjegjësia është individuale dhe kryeministri nuk mund të dijë çfarë bëjnë njerëzit e tij pas shpine, edhe kur këta hanë mollë dhe dardha. Vetëm se çështja këtë herë është më e rëndë. Hetimi ka çuar në arrest shtëpie ish-drejtuesen e SHISH, Vlora Hyseni, një skandal që ka prekur themelet e shtetit dhe për të cilën Rama bëri të paditurin.

I ndërgjegjshëm se i njëjti refren për "mollë dhe dardha që ia hanë pas shpine" nuk e bën më të njëjtin efekt siç e bënte dikur, Rama e artikuloi vetë pyetjen që sot e ngre gjithkush:

"Po si mund të mos e dija? Po si mundet që të mos jem i përzier unë vetë? Po si mund të them prapë se m'i hëngrën dardhat pas shpinës? Po si? Si?...", tha ai duke e dhënë vetë përgjigjen.

Sipas tij një kryeministër nuk duhet të gjykohet për njerëzit që ka emëruar apo afruar pranë vetes, por nga mënyra se si sillet, pasi ata kapen nga drejtësia.

"Një kryeministër nuk gjykohet dot me pretendimin absurd, që asnjë njeri i lidhur me të nuk do ta shkelë kurrë ligjin, sepse përndryshe shkelësi është ai vetë. Kryeministri dhe krejt shumica qeverisëse gjykohej nga qëndrimi që mbajnë dhe veprimi që bëjnë, kur hapet llogaria e drejtësisë për dikë mes tyre apo pranë tyre", tha Rama.

Duke shkuar akoma më tej kësaj logjike absurde që e zhvesh liderin nga çdo përgjegjësi politike, Rama e përmbysi edhe pyetjen që bëri vetë, duke thënë se nuk

ide



Një histori korruptimi jo dashurimi
Blendi Kajsia



Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm
Andi Bushati

MOTITIRANA

21°C

KËMBIMIEURO

91.97

aktuale

15:00

Rama lan duart me skandalin e SHISH: Çështje individuale e Vlora Hysenit me drejtësisë

22:06



Rama nis sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasi direkt pas kthimit



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndriqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



duhet pyetur “Si ka mundësi të mos e dijë kryeministri kur një vartës i tiji shkel ligjin?”, por “Si mund ta dijë kryeministri që vartësi i tij po mendon ta shkelë ligjin apo po vepron fshehtazi në shkelje të ligjit?”.



Teorikisht, argumenti i Ramës edhe mund të qëndrojë; një kryeministër s' mund ta dijë për çdo ryshfet që merr një drejtor, çdo tender që manipulon një zyrtar apo çdo marrëveshje të paligjshme që bëhet fshehurazi në administratë.

Praktikisht, po të shohësh përgjimet e Ergys Agasit të siguruar nga SPAK, rezulton e pamundur që një njeri pa asnjë funksion publik, të kishte akses dhe ndikim në disa prej institucioneve më të rëndësishme të shtetit. Le t'i marrim me radhë:

Vlora Hyseni dhe shpresa për një ndërhyrje nga “KM”



Rasti më i drejtpërdrejtë që tregon se Rama kishte njohje personale me Ergys Agasin është dosja e SPAK ku janë zbardhur mesazhet e Vlora Hysenit. Ato tregojnë se shpresa e Ergys Agasit dhe Vlora Hysenit ishte se Rama do të ndërhynte për t'i ndihmuar në mënyrë që Agasi të mos prekej nga policia.

Në një prej mesazheve Hyseni i shkruante: “Po më presin me shku te km... Jo mo zemer unë nje ore nuk rri me shume me ate”. Në një tjetër e njoftonte: “Neser duhet ta takoj km ne 830”. Por komunikimi më domethënës është ai i 19 gushtit 2026, në një moment kur situata e Agasit ishte rënduar dhe në Francë ishte arrestuar Ermal Beqiri. Hyseni e informonte se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Skënder Hitaj, e kishte thirrur për takim: “Skenderi me thirri me u taku te hënën...”, dhe më pas shtonte: “Të shpresojmë që ka porosit km..”.



Saimir Tahiri paralajmëron rikthimin: Do shihemi së shpejti, ka kaq shumë për të thënë



Rama niset sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasë direkt pas kthimit



"Vlora Hyseni dhe Ergys Agasi u njohën në Kryeministri"



FOTOLAJM/ Pankarta "Arrestoni Ramën" dhe mesazh për UÇK-në në "Air Albania"

Mesazhi është i tillë që tregon se Vlora Hyseni dhe Ergys Agasi shpresonin të një ndërhyrje e kryeministrit në polici, njësoj siç kishte ndodhur me Ilir Prodën që ishte në shërbim të Agasit. Pse dy njerëz në pozicionet e tyre mendonin se kryeministri mund të ndërhynte te drejtuesi i policisë? Pse Vlora Hyseni kishte bindjen se Rama do t'i ndihmonte? Mesazhet janë një provë e tërthortë se Rama ka qenë pjesë e komunikim të afërt me ta dhe jo më kot, çifti shpresonte tek një ndihmë nga ana e tij. Megjithatë hetuesit e SPAK nuk janë thelluar në këtë pjesë dhe kryeministri sot pretendon të kundërtën.

Kontrolli i Agasit në tenderat e AKSHI-t?



E njëjta pyetje shtrohet për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Ergys Agasi themeloi EA Solution më 15 shtator 2023 me kapital vetëm 1 mijë lekë. Brenda tre muajve e gjysmë kompania deklaroi 242.4 milionë lekë të ardhura dhe 232.1 milionë lekë fitim para tatimit, ose një normë fitimi rreth 95.7 për qind. Hetimi i SPAK-ut dyshon se ky sukses financiar nuk vinte nga ndonjë produkt teknologjik, por se EA Solution ishte përdorur për kalimin e parave të përfituara nga Soft & Solution drejt Agasit.

Nga materialet e dosjes, Agasi shfaqet si njeriu që kontrollon procedurat, fondet dhe mënyrën si do të ndaheshin kontratat e AKSHI-t. Në njërën nga bisedat e zbardhura në dosjen e SPAK, ai dëgjohet që i bie shkurt kur flet për një tender me logjikën “nga 2 e bëjmë 4” milion euro, ndërsa Mirlinda Karçanaj, drejtuesja shumëvjeçare e AKSHI-t, sipas akuzës së SPAK-ut, ishte pjesë e mekanizmit që favorizonte kompanitë e lidhura me grupin.

AKSHI është një agjenci nën varësinë e direkt të kryeministrit, që administron sisteme dhe kontrata me vlerë qindra milionë euro. A mundej që një person privat të arrinte një nivel të tillë ndikimi mbi drejtuesit e një institucioni nën Kryeministri, vetëm nëse nuk do të kishte miratimin direkt të Edi Ramës? Edhe një herë, faktet janë kundër deklaratave të kryeministrit.

Policia në gjunjë përballë Ergys Agasit





Padituria e Ramës bëhet akoma më e pabesueshme kur ndikimi i Agasit mbërrin te policia e shtetit. Në momentin e arrestimit ai ishte shoqëruar nga **Uljan Shpataraku** një ish drejtues i policisë së shtetit, ndërsa SPAK ka marrë në pyetje për të njëjtën dosje edhe ish-drejtorin e përgjithshëm të policisë, **Ilir Prodën**. Të dy dyshohen si lidhje e drejtpërdrejt e Ergys Agasit.

Për më tepër, Gerond Meçe, biznesmeni që konkurronte dhe ankimoi procedurat e prokurimit të AKSHI-t, ka deklaruar se përpara pengmarrjes së tij kishte marrë një paralajmërim nga zv.drejtori i Policisë së Tiranës, **Erjon Ismaili**, që të qëndronte larg tenderëve të AKSHI-t. Pikërisht kjo dëshmi u përdor për hetimin e lidhjeve të Ismailit me grupin dhe ndaj tij më pas u raportua masë pezullimi nga detyra.

Më 12 gusht 2025, persona që u prezantuan si oficerë të BKH-së e morën Meçen dhe e çuan në zonën e njohur si Kilometri 26, në rrugën e vjetër Tiranë-Elbasan. Sipas hetimit, atje e kërcënuan atë dhe familjen e tij për ta detyruar të hiqte dorë nga ankimet në tenderët e AKSHI-t. SPAK ka ngritur dyshime se Agasi kishte rol organizues në pengmarrje.

Një tjetër hallkë e dyshuar brenda Policisë së Shtetit që shfaqet në dosjen e Ergys Agasit është **Fatjon Kalluqi**, punonjës i Policisë Shkencore. Sipas raportimit, me kërkesë të SPAK-ut ishte kryer ekspertimi i një "Land Rover Defender" të zi, të sekuestruar më 22 korrik 2026 në garazhin e vilës së Agasit pranë kompleksit "Equos Resort". Automjeti po ekzaminohej për gjurmë gishtash, fije flokësh dhe për t'u krahasuar me pamjet e mjetit të të njëjtit tip që dyshohet se ishte përdorur në rrëmbimin e biznesmenit Gerond Meçe. Akt-ekspertimi i Policisë Shkencore iu përcoll SPAK-ut, por sipas të njëjtit raportim, disa ditë më vonë tri faqe të dokumentit hetimor iu dërguan në "Signal" edhe Ergys Agasit nga Fatjon Kalluqi.

Kur këto fakte vendosen bashkë, alibia e Ramës se ai nuk dinte asgjë, nis të fusë ujë.



Rama pranoi në fjalimin e tij se "me siguri" ka fajet e veta, duke shtuar se "nuk jam ëngjëll e as i pagabueshëm", por këmbënguli se nuk mund të bëhet përgjegjës për shkeljet që njerëzit kryejnë fshehurazi.

Por pasi i je rikthyer historisë së plotë, versioni që tregon Rama bëhet shumë fantastik për të qenë i vërtetë.

Kështu na del se Ergys Agasi bëri për vete drejtuesen e AKSHI-t dhe kontrollonte tenderat e institucionit me qindra miliona lekë, korruptoi shefat e policisë dhe i urdhëronte ata për presion ndaj biznesmenëve konkurrentë, siguronte dokumente të hetimit nga policia shkencore kur ishte në arrati, ndërkohë merrte informacione nga drejtuesja e SHISH-it dhe kishte ndikim edhe në institucione të tjera si tek Kadastra, të

gjitha këto nën hundën e një kryeministri që kuptonte asgjë.

Me pak fjalë, Shqipëria paska pasur për vite me radhë dy kryeministra. Një leshko që dilte çdo ditë në televizor dhe tjetrin që kishte çelsat realë të shtetit. I pari nuk e dinte se ekzistonte i dyti.

Sigurisht që me këtë version të ngjarjeve që Rama po na propozon të jemi të gjithë leshko dhe të besojmë se për vite me radhë, atij nuk i paskan ngrënë vetëm frutat pas shpine. I kanë marrë pemët, bahçen, gardhin dhe të gjithë shtetin. Kurse ai thjesht nuk e dinte./Lapsi.al